

**LIGJI Nr. 04/L-145 PËR ORGANET QEVERTARE PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR ORGANET QEVERTARE PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i organeve përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe kompetencat, përgjegjësitë, organizimi dhe funksionimi i tyre.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Ky ligj përcakton institucionet kompetente, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, themelimin e Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, si dhe konsolidimin e funksioneve dhe të përgjegjësive në fushën e zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK).

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjencia** - Agjencia për Shoqërinë e Informacionit;

1.2. **Struktura përkatëse organizative ose Zyrtari** – Struktura përkatëse organizative apo Zyrtari përgjegjës për menaxhimin e TIK-ut në çdo institucion të Republikës së Kosovës për kryerjen e shërbimeve të përbashkëta dhe përkrahjen e TIK-ut në atë institucion;

1.3. **E-Qeverisja** - qeverisje elektronike për ofrimin e shërbimeve të institucioneve qeveritare përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit Qeverisë, bizneseve dhe qytetarëve;

1.4. **Qendra e të dhënave** - Qendra shtetërore e të dhënave elektronike - baza e të dhënave shtetërore elektronike për akumulimin, administrimin, ofrimin dhe ruajtjen e të dhënave;

1.5. **TI** - Teknologjia e Informacionit;

1.6. **TIK** - Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit.

**Neni 4**  
**Strukturat përgjegjëse për shoqërinë e informacionit**

1. Strukturat përgjegjëse për shoqërinë e informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës janë:

- 1.1. Agjencia për Shoqërinë e Informacionit;
- 1.2. Struktura përkatëse organizative apo Zyrtari për menaxhimin e TIK-ut.

**Neni 5**  
**Themelimi i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit**

1. Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) themelohet si agjenci ekzekutive qeveritare në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, apo në organin e lartë pasuese të administratës shtetërore që vendos Qeveria.

2. Agjencia është organ qendror i administratës shtetërore për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, për institucionet e Republikës së Kosovës.

**Neni 6**  
**Funksionet e Agjencisë**

1. Agjencia ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

- 1.1. propozon dhe koordinon të gjitha politikat që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës.
- 1.2. harton dhe siguron zbatimin e strategjisë së qeverisjes elektronike dhe të planit të veprimit përkatës, për aprovim në Qeveri.
- 1.3. udhëheq dhe mbikëqyr zbatimin e projekteve që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës.

2. Agjencia përkrah zhvillimin e teknologjisë së informacionit, nxit investimet në fushën e shoqërisë së informacionit, zhvillimin e sistemeve të aftësisë në teknologjinë e informacionit dhe bën koordinimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e proceseve dhe të mekanizmave të qeverisjes elektronike në fushat e mëposhtme:

- 2.1. infrastrukturën e TIK-ut për institucionet e Republikës së Kosovës dhe rritjen e shkallës së përdorimit të TI-së;
- 2.2. zgjerimin e shërbimeve të internetit dhe të përmbajtjeve të internetit në institucionet e Republikës së Kosovës;
- 2.3. akumulimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave, duke krijuar Qendrën shtetërore të të dhënave elektronike;
- 2.4. sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës komunikuese elektronike dhe të të dhënave;
- 2.5. sipas nevojës, ndihmon institucionet relevante në luftimin e krimit elektronik (cyber crime);

2.6. përkujdeset për menaxhimin dhe ruajtjen e pronës intelektuale dhe të drejtat në lidhje me bazat e të dhënave dhe softuerët, që janë pronë e shtetit;

2.7. siguron mbrojtjen e të dhënave personale në formë elektronike, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

2.8. ndihmon qasjen në informata publike në formë elektronike;

2.9. në bashkpunim me IKAP-in bën identifikimin e nevojave për aftësimin elektronik të Shoqërisë së Informacionit për punonjësit e institucioneve të Republikës së Kosovës.

## **Neni 7**

### **Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë**

1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet në pajtim me rregullat dhe procedurat për emërimin e pozitave të larta drejtuese në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

2. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë është përgjegjës për:

2.1. administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të Agjencisë dhe garantimin e zbatimit të funksioneve, që i janë besuar Agjencisë;

2.2. ofrimin e udhëzimeve të sakta e të paanshme dhe këshillave profesionale për institucionet e Republikës së Kosovës në fushën e TIK-ut;

2.3. menaxhimin efikas të burimeve njerëzore dhe financiare me të cilat disponon Agjencia, si dhe

2.4. zbatimin e përgjegjësive të tjera në mënyrë analoge me përgjegjësitë e Sekretarit të përgjithshëm të ministrisë, siç është përcaktuar me Ligjin për Administratën Shtetërore.

## **Neni 8**

### **Struktura, zyrtari përkatës dhe bashkërendimi në TIK**

1. Çdo institucion i Republikës së Kosovës, duhet të ketë Strukturën përkatëse organizative apo Zyrtarin përkatës për menaxhimin e TIK-ut.

2. Struktura përkatëse organizative apo Zyrtari përkatës është përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të përbashkëta dhe përkrahjen e TIK-ut në institucionin përkatës.

3. Struktura përkatëse organizative apo Zyrtari përkatës në institucion vepron në përputhje me politikat, standardet dhe udhëzimet në fuqi lidhur me TIK-un.

4. Të gjitha institucionet paraqesin kërkesat e tyre në Agjenci për të gjitha investimet e planifikuara në fushën e TIK-ut.

5. Agjencia në pajtim me politikat dhe strategjitë e qeverisjës elektronike, shqyrton kërkesat për investimet planifikuara dhe propozon buxhetin e agjencisë për realizimin e tyre, si dhe bën implementim e tyre.

6. Mënyra e koordinimit të punëve në mes të Strukturës përkatëse organizative apo Zyrtarit përkatës për menaxhimin e TIK-ut në institucione dhe Agjencisë, përcaktohet me akt nënligjor, të propozuar nga Ministria përgjegjëse për administratë publike dhe të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

## **Neni 9 Buxheti i Agjencisë**

Agjencia financohet nga Buxheti i Kosovës.

## **Neni 10 Dispozitat kalimtare**

1. Ministria përgjegjëse për administratë publike ndërmerr masat e nevojshme që në afat prej gjashtë (6) muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të shndërrojë departamentin e E-qeverisjes dhe proceseve administrative në Agjenci, duke përfshirë këtu burimet dhe infrastrukturën përkatëse.
2. Me iniciativën dhe propozimin e ministrisë përkatëse për administratë publike, Qeveria vendos të bëjë transferimin e përgjegjësisë të institucioneve tjera qeveritare në Agjenci,
3. Institucionet të cilat gëzojnë pavarësi kushtetuese, të cilat janë të përjashtuara nga zbatimi i këtij ligji, kanë të drejtë të lidhin marrëveshje mirëkuptimi me ministrinë përgjegjëse për administratë publike për ato fusha për të cilat këto institucione mund të përfitojnë nga agjencia për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.
4. E drejta e titullarit të të gjitha pasurive fizike dhe intelektuale të departamenteve të teknologjisë Informative dhe të njësive tjera të TI dhe TIK që kalojnë në Agjenci, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i jepen Agjencisë.

## **Neni 11 Aktet nënligjore**

1. Brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria përgjegjëse për administratë publike propozon për miratim në Qeveri aktet nënligjore për transformimin e organeve të reja qeveritare të shoqërisë së informacionit, të formuara sipas këtij ligji, të resurseve njerëzore, të inventarit, të infrastrukturës dhe të buxhetit të tyre, si dhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.
2. Çështjet e transferimit të resurseve njerëzore, të inventarit, të infrastrukturës dhe të buxhetit bëhen me marrëveshje brenda qeveritare.
3. Agjencia, në afat prej një (1) viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, propozon politikat dhe standardet themelore për shërbimet e TI-së, të cilat duhet të miratohen nga Qeveria. Këto politika dhe standarde duhet të rishikohen dhe të plotësohen në vazhdimësi.

## **Neni 12 Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-145  
18 prill 2013**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-021-2013, datë 02.05.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës  
Atifete Jahjaga.**